REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës:	2023:258073
Datë:	09.02.2024
Numri i dokumentit:	05310568

C.nr.4317/23

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi, duke vendosur në çështjen juridiko kontestimore të paditëses Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - SH.A., (KEDS), me adresë në Prishtine, kundër të padituri N. (R) Z. me numër personal, me vendbanim Malësi e Re, Komuna e Prizrenit, me objekt të padisë kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 88,47€, jashtë seancës gjyqësore, me datën 24.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Lëshohet urdhërpagesa për paditësin Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - SH.A., (KEDS), dhe detyrohet i padituri N. (R) Z. me vendbanim Malësi e Re, që në emër të kompensimit të dëmit, t'ia paguaj paditësit shumën në lartësi prej 88,47€ (tetëdhjetë e tetë euro e katër dhjetë e shtatë cent) me kamatë ligjore prej 8 %, e cila fillon te rrjedhe nga dita e paraqitjes së kësaj padie me datë 15.11.2023 e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet faktike të përmbarimit, të gjitha këto në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë, apo që brenda afatit të njëjtë të parashtroj prapësimin kundër kësaj urdhërpagese.

A r s y e t i m

Paditësja Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike - SH.A., (KEDS) - Distrikti në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të padituri kundër të padituri N. (R) Z. me numër personal ..... me vendbanim Malësi e Re, Komuna e Prizrenit, me objekt të padisë kompensimi i dëmit material, vlera e kontestit 88.47€.

Paditësja padisë ia ka bashkangjitur Aktgjykimin e plotfuqishëm të Gjykatës Themelore në Prizren nën shenjen: P.nr.431/20 i datës 13.01.2022 dhe Faturën me nr. DPZHP2015393 të datës 07.04.2020.

Me Aktgjykimin P.nr.431/20 i datës 13.01.2022, vendim ky i cili është bërë i plotfuqishëm me datën 08.02.2022, gjykata ka vërtetuar se i padituri është shpallur fajtor për shkak të kryerjes së veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 314 të Kodit Penal të Kosovës, dhe me

2023:258074

faturën nr. DPZHP2015393 të datës 07.04.2020, konstatohet se i padituri për shkak të rikthimit të humbjeve për shfrytëzimin e energjisë elektrike ne mënyre të paautorizuar, paditësit duhet ti paguaj shumën e lartcekur.

Nga se u tha më lartë, e konform dispozitave ligjore të nenit 493.3 dhe 495 lidhur me nenin 497.1 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2023:258073, 24.01.2024

G j y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLA JURIDIKE: I padituri mund ta godisë urdhërpagesën vetëm me anë të prapësimit dhe atë brenda afatit 7 ditor pas ditës së pranimit të së njëjtës. Prapësimi i paraqitur me vonesë do të hudhet poshtë.

2023:258074